



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr. 4529 Regj.Them.

Datë Regjistrimi 10/10/2018

Data e Vendimit 23/10/2018

V E N D I M
"NE EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga

GJYQTAR : ARDIAN KALIA

asistuar nga sekretare gjyqësore Beglie NURA, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, sot me datë 23/10/2018, përfundoi shqyrtimin, e kërkesës penale, e cila i përket:

Kërkues: M. C., i biri i E., i dtl.02/08/19.., lindur në Tradate e banues në adresën ..., Milano Itali, me kombësi e shtetësi italiane, në mungesë, i përfaqësuar në gjykim me mbrojtës të zgjedhur prej tij me akt përfaqësimi Nr...., date 16/11/2017, Av.Besnik ÇEREKJA, me Nr.2693 License dhe NIPT K82108008O, Anëtar i Dhomës së Avokatëve Tiranë.

Kundër: Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përfaqësuar në gjykim nga Prokurore Anisa QILIMI.

Objekti: Mbi kundërshtimin vendimeve të Prokurorit për sekuestrimin e llogarive bankare të ankuesit për llogari të procedimit penal Nr.9506/2018.

Baza Ligjore: Nenet 208, 210, 212, 217, 301 të K.Pr.Penale.

Gjykata, pasi verifikoi kryesisht juridiksionin e kompetencën për shqyrtimin e kësaj kërkesë, dëgjoi palët në diskutimin përfundimtar, të cilët kërkuan respektivisht: Mbrojtësi i kërkuesit – Pranimin e kërkesës; Prokurore Anisa QILIMI – Rrëzimin e kërkesës; dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V E R E N:

Se Kërkuesi M. C. ka vënë në lëvizje Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesën me objekt dhe referencë ligjore si më lart, kërkesë e cila është regjistruar nga K.Sekretaria gjyqësore e asaj Gjykate në dt.10/10/2018.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj kërkesë, rezultoi e provuar se, me vendime të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 23/11/2017, është disponuar me vendosjen e sekuestros mbi llogaritë bankare që rezultojnë në emër të Ankuesit, në disa nga bankat e nivelit të dytë

që operojnë në Republikën e Shqipërisë dhe konkretisht, “Credins Bank” sh.a, Banka Ameraiane e Investimeve, “Alpha Bank”, Sha, Tiranë dhe Banka “Intesa Sanpaolo Albania” Sh.a.

Gjithashtu, nga aktet shkresore provuese të paraqitura nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqsor Tiranë, rezulton se, veprimet e lartpërmendura procedurale janë marrë në vijim të një procedimi penal të filluar nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqsor Tiranë. Më konkretisht, ky organ mbi bazën e materialit referues nga Komisariati i Policisë për Kufirin dhe Migracionin, Aeroporti “Nene Tereza”, Tirane ka regjistruar procedimin penal Nr. 9506, i cili ben fjale për veprën penale të “Mosdeklarimit në kufi të hollave dhe sendeve me vlerë”, parashikuar nga neni 179/a i Kodit Penal, në ngarkim të pandehurit M.C..

Mbi bazën e referimit të materialit procedural nga Drejtoria Vendore e Policisë Tirane, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkalles së Parë Tirane, ka regjistruar procedimin penal Nr. 10297 për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të vepres penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, pa emer.

Në vijim rezulton se, Procedimet penale Nr. 9506/2017 dhe Nr. 10297/2017 janë bashkuar në një procedim penal të vetëm me Nr. 9506/2017. Në përfundim të veprimeve hetimore për veprën penale të parashikuar nga neni 179/a të Kodit Penal, shtetasit M. C. i është njoftuar akuza kundrejt nënshkrimit në prani të avokatit të tij, si dhe është pyetur në cilësinë e pandehurit. Nga ana e Prokurorisë rezulton të jetë bërë ndarja e çështjes penale me Nr.9506/2017 dhe proceduar me kerkese në gjykatë me kerkese për miratim urdhri penal.

Fakti objekt hetimi penal i referohet ngjarjes së datës 15.11.2017 ora 15.00 kur, shërbimet policore të hetimit të krimeve në Komisaratin e Policisë Rinas gjatë përpunimit të pasagjereve të linjes ajrore Blu Panorama me itinerar Tirane-Milano, në PKK Rinas është kapur në flagrancë duke u ndaluar për kontroll në vijën e dytë shtetasi italian M.E.C.dtl 19.. në Itali, pasi gjatë kontrollit të valixhes, brenda corapeve të tij me ngjyrë të zeze ju gjeten 350.000 euro. Me vendimin Nr. 606, datë 02.03.2018 të Gjykatës së Shkalles së Parë Tirane është refuzuar miratimi i urdhrit penal dhe është vendosur kthimi i akteve të procedimit penal në ngarkim të M. C. për hetime të metejshme, ndërmjet të tjerash për të hetuar origjinën e monedhave të sekuestruara, si dhe nëse ka pasur raste të tjera të mosdeklarimit në kufi të hollave. Në këto kushte pas kthimit të akteve të procedimit penal me Nr. 9506/2017 me vendim bashkimi të prokurorit të çështjes është bërë perseri bashkimi i procedimit me Nr. 9506/2017 me procedimin 10297/2017, në një procedim të vetëm me Nr 10297/2017.

Për hetimin e procedimit penal është shkëmbyer leterporosi me autoritetet italiane të drejtësisë, të cilët janë vënë në dijeni të ekzistencës së një procedimi penal në ngarkim të shtetasit M. C.. Për më tepër, nisur dhe nga disponimi i gjykatës në arsyetimin e vendimit gjyqësor Nr. 606, datë 02.03.2018 lidhur me origjinën e monedhave dhe nëse ka patur raste të tjera, nga verifikimi i kryer në sekretarinë e prokurorisë rezultojnë me interes aktet e procedimit penal Nr. 2556/2017.

Procedimi penal Nr. 2556/2017 i është bashkuar nga ana e organit të Prokurorisë, procedimit penal Nr.4974/2017, me arsyetimin se, bëhej fjalë për të njëjtët persona dhe të njëjtët burime,

ndermjet tyre shtetasin M.C.. Ky procedim penal eshte regjistruar dhe hetuar per vepren penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale ose te veprimtarise kriminale". Me vendimin e dates 25.07.2017 nga prokurori i ceshtjes eshte disponuar me vendim per pushimin e procedimit penal Nr 2556/2017 pasi faktet e rezultuara nga hetimi nuk parashikohen si veper penale. Kopje e akteve te procedimit penal Nr. 2556/2017, duke u çmuar ne interes te procedimit penal eshte marre me vendim per marrjen e akteve dhe eshte administruar si pjese perberese e fashikullit hetimor me Nr. 10297/2017.

Nisur nga permbajtja e akteve te procedimit penal Nr. 10297/2017, rezulton se është shkëmbyer leterporosi me autoritet italiane te drejtesise, në drejtim të hetimit pasuror dhe precedenteve penale te meparshem per subjektin objekt hetimi. Më konkretisht, nga ana e organit të akzues, rezulton t'i jetë drejtuar shkrese Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, nese shtetasi M. C. eshte subjekt qe mbart pergjegjesi tatimore ne territorin e Republikës Shqiperise. Gjithashtu rezulton të jetë administruar praktika e leterporosise me autoritetet italiane te drejtësisë dhe sipas organit të Prokurprisë, është në pritje pergjigje nga Banka Intesa San Paolo. Nga aktet e kerkeses per ndihme juridike te autoriteteve italiane te drejtesise te ardhur ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane ne date 12.09.2018, është konfirmuar se Prokuroria e Italise po zhvillon hetime ndaj C.M., G.J. dhe F. A. per vepren penale te "Mashttrimit tatimor te kryer ne bashkepunim" dhe "Pastrimit te parave qe rrjedhin nga vepra penale e mashttrimit fiskal".

Nga ana e përfaqësuesit të ankuesit u pretendua në gjykim se, ndonëse vendimet e lartpërmendura të sekuestros datojnë nga 23/11/2017, ankuesi është vënë në dijeni në lidhje me to vetëm në dt.08/10/2018, në vijim të përgjigjes së dhënë nga ana e Prokurorisë, mbi një kërkesë të drejtuar organit të akuzës nga ana e mbrojtësit të Ankuesit.

Sipas Ankuesit, masat e sekuestros të marra me vendimet e datës 23/11/2018 vinë ndesh me ligjin procedural penal si dhe me veprën penale për të cilën është duke u hetuar nga ana e organit të akuzës, "Mosdeklarimi i të hollkave në kufi", e cila është një vepër penale formale dhe ligjin nuk kërkon praktikisht ardhjen e ndonjë pasoje. Në këtë këndvështrim, sipas mbrojtësit, është e pakuptim të vendoset sekuestro mbi llogaritë bankare të ankuesit.

Sipa mbrojtësit, sekuestroja e vendosur nga organi i akuzës vjen ndesh me përcaktimet e ligjit procedural penal dhe konkretisht nenet 210 e 217 të K.Pr.Penale, ndaj, në përfundim, nga ana e mbrojtësit u kërkua heqja e sekuestros mbi llogaritë bankare të ankuesit në katër bankat e nivelit të dytë, "Credins Bank" sh.a, Banka Ameraiane e Investimeve, "Alpha Bank", Sha, Tiranë dhe Banka "Intesa Sanpaolo Albania" Sh.a, duke shfuqizuar vendimet e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 23/11/2017.

Nga ana e saj, Prokurore Anisa Qilimi.i kërkoi Gjykatës rrëzimin e kërkesës ankimore dhe lënien në fuqi të vendimet e sekuestrimit të llogarive bankare, të datës 23/11/2017. Sipas Prokurores, ekzistojnë të gjitha kushtet ligjore për marrjen e kësaj mase në këtë fazë të hetimeve. Nga ana e Prokurores, për të kundërshtuar pretendimet e ngritura nga ana e përfaqësuesit të ankuesit, u parashtrua veç të tjerash se: "Nuk eshte e vertete qe mbrojtja dhe i pandehuri C.M.nuk kane pasur dijeni per sekuestron e vendosur. Aktet e sekuestrimit kane gene pjese e fashikullit hetimor ne momentin e njoftimit te akuzes, pyetjes se te pandehurit

dhe njoftimit te perfundimit te hetimeve. I pandehuri dhe mbrojttesi i tij nuk mund te ngrene pretendimin qe jane njohur me aktet ne date 08.10.2018, nderkohe qe ne momentin e njoftimit te akuzes dhe pyetjes se te pandehurit aktet e sekuestros kane qene pjese e fashikullit hetimor. Pavarësisht se gjykata nuk ka miratuar urdhrin penal i pandehuri dhe avokati kane qene ne dijeni te sekuestros se vendosur”.

Në përfundim, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqsor Tiranë u kërkua rrëzimi i kërkesës ankimore të paraqitur nga ana e Ankuesit M. C., si e pambështetur në prova e ligj.

LIGJI I APLIKUESHEM

Neni 208 i K.Pr.Penale

“1.Gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve. 2. Sekuestrimin e kryen vetë ai që ka nxjerrë vendim ose oficerët e policisë gjyqësore të deleguar me të njëjtin vendim. 3. Kopja e vendimit të sekuestrimit i dorëzohet të interesuarit, në qoftë se është i pranishëm”.

Neni 210 i K.Pr.Penale

Gjykata mund të vendosë sekuestrimin pranë bankave të dokumenteve, letrave me vlerë, shumave të depozituara në llogari rrjedhëse dhe çdo gjëje tjetër, edhe nëse gjenden në kasetat e sigurisë, kur ka arsye të bazuara për të menduar se ato kanë lidhje me veprën penale, edhe kur nuk i përkasin të pandehurit ose kur nuk janë në emër të tij. Në raste të ngutshme ky vendim mund të merret nga prokurori”.

VLERËSIMI I GJYKATËS

Nga shqyrtimi i pretendimeve dhe prapsimeve të parashtruara në gjykim nga palët ndërgjyqëse, nga shqyrtimi i akteve shkresore provuese të paraqitura nga ana e mbrojtësit të Ankuesit dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqsor Tiranë, në interpretim të dispozitave të legjislacionit procedural penal të cilat, disiplinonjë masat e përkohshme në procesin penal, specifikisht sekuestrimet si mjet për kërkimin e provës, duke përfshirë dhe sekuestrimet pranë bankave, Gjykata vlerëson se, pretendimet e parashtruara nga ana e ankuesit, janë të pambështetura ligjërisht ndaj kërkesa ankimore duhet rrëzuar.

Duke i trajtuar masat e sekuestrimit të llogarive bankare, të marra nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqsor Tiranë, me vendimet e dt.23/11/2017, në vështrim të dispozitave të neneve 208 e 210 të K.Pr.Penal, si dhe mbështetur në parimet e përgjithshme të ligjit procedural penal të Republikës së Shqipërisë, Gjykata vlerëson se, nga tërësia e akteve të paraqitura në cilësinë e provës nga ana e përfaqësuesit të akuzës, provohet ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm, si premisë me të cilën, ligji procedural penal, lidh mundësinë e marrjes së masës së sekuestros. Në një konkluzion të tillë, Gjykata arrin duke iu referuar faktit të provuar sikundër më lart, si dhe përgjigjeve me shkrim të ardhura në kuadrin e kërkesës për ndihmë juridike drejtuar autoriteteve të drejtësisë italiane, pranisë së dyshimeve të arsyeshme në lidhje me veprimtari të jashtëligjshme të ankuesit M. C..

Në përfundim, duke i trajtuar masatat e sekuestros të marra nga ana e Prokurorisë si masa të përkohshme dhe në funksion të një procedimi penal, njëherazi të mbështetur ligjërisht për sa është disponuar në vendimet e datës 23/11/2017, Gjykata çmon të disponojë me rrëzimin e kërkesës ankimore të parashtruar nga ana e ankuesit M. C..

PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar ne nenet 112, 208, 210, 212 të K.Pr.Penale

VENDOSI

Rrëzimin e kërkesës.

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen Ankuesit.

Kundër vendimit lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 5 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.

U shpall në Tiranë sot, me dt.23/10/2018.

SEKRETARE
BEGLIE NURA

**

GJYQTAR
ARDIAN KALIA